



Pranuar / Dorezuar Prilijena/Prodato Received/Delivery	20.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shturca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2958/2022		1/1



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.336/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.336/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar nga Avokat

kundër Vendimit me numër 07/4 Prot.934 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.336/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 07/4 Prot:934 i datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.**

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë, përmes përfaqësuesit të tij, më datë 06.04.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1901/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 07/4 Prot:934 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me pretendimet për shkelje ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.04.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa

Këshilli, më datë 21.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 06.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i avokati për përfaqësim i datës 01.04.2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 02.08.2017; Vendimi i datës 14.06.2018; Shkresa e datës 26.05.2021 për shqyrtimin e kërkesave për Komisionin Disiplinor; e-mail i datës 26.05.2021; 25.05.2021; Informim i datës 03.03.2021; Vendimi i datës 30.03.2021 për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës; Kërkesa e datës 09.03.2021 për marrje të dokumentacionit; Kërkesa e datës 16.03.2021 për marrje të dokumentacionit; Kërkesa e datës 01.04.2021 për sigurimin e informatave dhe dokumentacionit; Kërkesa e datës 21.04.2021 për marrje të dokumentacionit; Kërkesa e datës 17.05.2021 për verifikim të gjendjes në teren; Njoftimi i datës 17.05.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë; Kërkesa e datës 20.05.2021 kërkesë për verifikim të gjendjes në teren; Kërkesa e datës 24.05.2021 për marrje të dokumentacionit; Vendimi i datës 30.03.2021 për emërimin e Komisionit Disiplinor; Kërkesa e datës 23.03.2021; e-mail i datës 23.03.2021; Informim i datës 03.03.2021; Shkresa e datës 25.03.2021 për shqyrtimin e kërkesës; Shkresa e datës 18.03.2021 për shqyrtimin e kërkesës; E-mail i datës 18.03.2021; Vendimi i datës 21.09.2020 për plotësim dhe ndryshimin e Vendimit të datës 12.09.2019; Vendimi i datës 12.09.2019 për emërimin e Komisionit Disiplinor; e-mail i datës 12.03.2021; Shkresa e datës 18.03.201 për shqyrtim të kërkesës; e-mail i datës 17.03.2021; Vendimi i datës 21.09.2020 për plotësim ndryshimi të vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 12.09.2019; Vendimi i datës 12.09.2019 për emërimin e Komisionit Disiplinor; E-mail i datës 12.03.2021; 11.03.2021; Procesverbali i datës 03.05.2021 i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 25.06.2021 për pezullim; e-mail i datës 25.02.2022; 25.01.2022; Vendimi i datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 22.02.2022 i Komisionit Disiplinor si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me provat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimit i provave materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me numër 04/2017 me Prot:4546 të datës 02.08.2017 është e punësuar në pozitën "Zyrtar Shpenzues", në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë ndërsa sipas Vendimit Ref.AZHB-07/4/177/2018 të datës 11.06.2018 të nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv ankuesi caktohet në punët dhe detyrat e punës "Zyrtar për Pagesa Direkt" në kuadër të Drejtorisë për Pagesa Direkte në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Bazuar në njoftimin e datës 03.03.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, drejtuar Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural për çka AZHB është njoftuar me datë 10.03.2021 për arrestimin e zyrtarëve për dyshimin e kryerjes së veprës penale "marrje ryshfeti dhe dhënie ryshfeti". Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së nxjerr vendimin REF.AZHB-07/4/45/2021 të datës 30.03.2021 me numër të protokollit 1420 me të cilin vendim pezullohet nga



Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë verën se i njëjti ju referohet pesë (5) nëpunësve civil, ku që të gjithë janë pezulluar nga Komisioni Disiplinor deri në një vendim tjetër, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.336/2022 të datës 06.04.2022 dhe lënia në fuqi e Vendimit me numër protokolli 934 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ka të bëjë vetëm me pjesën e ankuesit.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.336/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

